



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 4786/prot.  
2

Gramsh, më 07/12 /2022

VENDIM

Nr. 38 Datë 30.11.2022

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË EKR (EKSPERT KONTABËL I REGJISTRUAR) MBI  
VLERËSIMIN DHE TRANSFERIMIN E DISA AKTIVEVE AFAT GJATA  
MATERIALE NË FUNKSION TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË  
PIJSHËM, GRUMBULLIMIN, LARGIMI DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TË  
NDOTURA PRONË E BASHKISË GRAMSH NË VARËSI DHE NË KONTABILITET  
TË “UJËSJELLËS KANALIZIME GRAMSH” SH.A

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjet e tij të datës 30/11/2022, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për miratimin e Raportit të EKR (Ekspert Kontabël i Regjistruar) mbi vlerësimin dhe transferimin e disa Aktiveve Afat Gjata Materiale në funksion të shërbimit të furnizimit me ujë të pishëm, grumbullimin, largimi dhe trajtimin e ujërave të ndotura pronë e Bashkisë Gramsh në varësi dhe në kontabilitet të “Ujësjetllës Kanalizime Gramsh” Sh.A. mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës; Ligjin Nr. 139/2015 dt 17.12.2015 “Per qeverisjen vendore” neni 9 pika 1.1/a 1.1/b, neni 23, neni 54 pikat d, e dhe k, Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Përtregtarëdheshoqëritëtregetare” neni 125/1 neni 216 e nëvijim, Ligjin Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Përtransferimin e pronave të paluajtshmetëshitetitnënjësitë e qeverisjes vendore, VKM Nr. 63 datë 27/01/2016 “Përriorganizimin e operatorëve qe ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimindhetrajtimin e ujërave të ndotura, ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “qëndrënkombëtare të regjistrimit”.

V E N D O S I

1. Të miratojë raportin e EKR (Ekspert Kontabël i Regjistruar) për vlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të cilat do të transferohen tek shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A., dhe për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A. për vlerën e A.A.M. (Aktiveve Afatgjata Materiale) që do të transferohen nga Bashkia Gramsh tek shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A.

2. Të miratojëlistën e Aktiveve Afat Gjata Materiale për vlerën prej 474,506,279 lekë (lista inventariale bashkangjitur vendimit) të njësive të shërbimit të furnizimit me ujë të pishëm, grumbullimin, largimi dhe trajtimin e ujërave të ndotura pronë e Bashkisë Gramsh për inventarizim, vlerësim dhe transferim në kontabilitetin e “Ujësjetllës Kanalizime Gramsh” Sh.A.
3. Të miratojëzmadhimin e kapitalit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A. si rezultat i transferimit të A.A.M. (Aktiveve Afatgjata Materiale) nga Bashkia Gramsh tek shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A.për vlerën e A.A.M. që do transferohen.
4. Kapitali i shoqërisëUjësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A mbas pasqyrimin të këtij operacioni përbëhet nga një kuotë me vlerë 582,436,811 lekë, dhe zotërohet 100% nga Aksioneri Bashkia Gramsh.
5. Tëçregjistrohen nga inventari kontabël i Bashkisë Gramsh A.A.M që transferohen sipas pikës 2 të këtij vendimi
6. Për ndjekjen e procedurave të mëtejshme dhe regjistrimin në QKB ngarkohet Administratori i ShoqërisëUjësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A. ose personi i autorizuar prej tij.
7. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë dhe Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Gramsh Sh.A.
8. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**SEKRETARI KËSHILLIT**

**XHULIA GJINI**

Konc/Dakt. Xh.Gjini  
Konfirmoi:  
Miratoi. G.Lena  
Dosja \_\_\_\_\_  
Afati \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**GRETA LENA**